

AKTI I THEMELIMIT
&
STATUTI I SHOQËRISË
“ INTER.TEK WESTERN BALKANS ” SH.P.K
(Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar)

Në bazë të Ligjit 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, u vendos si më poshtë vijon:

KREU 1
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e themelimit dhe emri i shoqërisë

Sot më datë 15.01.2018 ne themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Inter.Tek Western Balkans” SH.P.K (në vijim referuar si “Shoqëria”).

Themeluesi i Shoqërisë janë ortaket:

FATION VEIZAJ, shtetas shqiptar, i biri i Sulo, lindur ne Vlorë, më 18/09/1966, banues në Tiranë, në adresën Rruga “Brigada VIII”, Pallati Nr. 5, Apartamenti 3, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. G60918033N, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

BESNIK LESKAJ, shtetas shqiptar, i biri i Astritit, lindur më 30.06.1976, banues në Tiranë, në adresën Blv “Bajram Curri”, Pallati Nr. 6 mbajtës i kartës së identitetit me Nr. 027826491, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar

REDJAN BASHA, shtetas shqiptar, i biri i Nylbiut, lindur ne Lazarat më 08.03.1984, banues në Tiranë, në adresën Blv “Gjergj Fishta”, Kulla Nr. 5, Kati 13, Ap. 65, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. I40308092C, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar

Neni 2

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

- a) Kontroll teknik i pajisjeve/instalimeve nen presion, i pajisjeve nen presion me vatra zjarri, i rezervuareve te GLN-se me kapacitet me te vogel, te barabarte ose me te madh se 13m3, i eneve kriogjenike, i depozitave te hidrokarbureve, i cisternave automobilistike, i grykes se pusit dhe armatureve se fontanes, i aksesoreve.

- b) Laborator për provat pa shkatërrim (NDT).
- c) Import-Eksport, përpunimi/prodhimi i mallrave të ndryshëm, ndërtimi të gjitha veprave civile, industriale (Nuk përfshihen në aktivitetet e sipërcituara pajisjet/produktet objekt inspektimi/kontrolli apo objekt vlerësimi të konformitetit).
- d) Inspektimin e impianteve: elektrike civile, elektrike industriale, elektrike në ambient me rrezik zjarri, të tokezimit, të mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike.
- e) Inspektimin e kabinave elektrike dhe që janë të tipeve shtyllore, parafabrikuara (box), murature, linjave elektrike ajrore, linjave elektrike kabllore, centraleve për prodhimin e energjisë elektrike duke përfshirë, godinat e hidrocentraleve dhe termocentraleve elektrik, impianteve të prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, nenstacioneve dhe dispozitiveve diferencial.
- f) Inspektimin e pajisjeve dhe makinerive ngritëse;
- g) Certifikim të personelit sipas legjislacionit në fuqi. Inspektimin e transportit të bombolave të GLN-se;
- h) Inspektimin e bombolave të GLN-se.
- i) Inspektimin e fushes elektromagnetike të pajisjeve/instalimeve elektrike.

Neni 3

Kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është për një afat të pacaktuar.

Neni 4

Selia

1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga "Themistokli Gërmenji", përballë RTSH, Kati II, Hyrja 2, Zona Kadastrale 8160, Nr. Pasurie 2/117 1+1-3, Volum 31, Faqe 24, Tiranë.
2. Shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin, brenda ose jashtë territorit të vendit, gjatë aktivitetit të saj.

Neni 5

Të Ndryshme

1. Kjo Shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, selinë, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të zmadhojë kapitalin sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë dhe sipas parashikimeve të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".


KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali i regjistruar

1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është **100,000 (njëqind mijë) Lekë**. Kapitali i regjistruar është plotësisht i paguar, dhe përbëhet nga 3 kuota, të zotëruara nga Ortakët sipas përcaktimeve si në vijim:
 - a) **Ortaku Fatjon Veizaj** zotëruar i një kuote me vlerë nominale 40.000 Lekë që përbën 40% të kapitalit themeltar;



- b) **Ortaku Besnik Leskaj** zotërues i një kuote me vlerë nominale 30.000 Lekë që përbën 30% të kapitalit themeltar ; dhe
- c) **Ortaku Redjan Basha** zotërues i një kuote me vlerë nominale 30.000 Lekë që përbën 30% të kapitalit themeltar.

Neni 7

Ortakët e Shoqërisë

1. Ortakët e Shoqërisë janë Personat që kanë përfituar kuoten e tyre në Shoqëri në përputhje me kontributin e tyre. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë ndahet midis Ortakëve në kuota në përputhje me kontributet përkatëse në kapital. Kontributi mund të jetë në para ose natyrë (pasuri të luajtshme apo të paluajtshme apo të drejta të ortakëve).
2. Ortakët aktuale të Shoqërisë janë të listuar në Shtojcën 1 që i bashkëlidhet këtij Statuti.
3. Ortakët angazhohen që në marrëdhëniet e veprimtarive tregtare që shoqëria do të krijojë pas regjistrimit, do të mbajnë së bashku qëndrim të unifikuar mbi të gjitha çështjet që lidhen me zhvillimin tregtar të shoqërisë.

Neni 8

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

1. Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë kryhet me vendim të Asamblese së Ortakëve.
2. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të përfshirjes së fitimeve apo rezervave në kapital ose me ane të kontributeve të reja.
3. Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar me anë të kontributëve të reja në para, këto kontribute duhet të nënshkruhen jo më vonë se 30 ditë pasi është vendosur rritja e kapitalit. Këto kontribute duhet të shlyhen plotësisht jo më vonë se 30 ditë pas datës së nënshkrimit. Asambleja e Ortakëve mund të përcaktojë afate të ndryshme në vendimin e zmadhimit të kapitalit.
4. Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar me anë të kontributeve të reja në natyrë, këto kontribute duhet t'i transferohen Shoqërisë përpara regjistrimit në Regjistrin Tregtar. Vlerësimi i kontributeve të reja në natyrë do të kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.
5. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë.
6. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
7. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 9

Fitimi dhe kalimi i kuotave

1. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet :
 - a. kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
 - b. shitblerjes së kuotave;
 - c. trashëgimisë;
 - ç. dhurimit;
 - d. çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.
2. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë janë të transferueshme ndërmjet ortakëve.
3. Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë përgjigjet në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës nga çasti i kalimit të kuotave deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

KREU III

ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 10

Organi vendimarrës

1. Organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.
2. Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteve të përcaktuara në ligj.
3. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të përshkruara si më poshtë:
 - a. përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b. ndryshimet e statutit;
 - c. emërimin e shkarkimin e administratorit;
 - ç. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
4. Ortaku mund të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
5. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe



mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Mënyra e thirrjes së Asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur Asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas paragrafit të mësipërm të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 12

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
2. Në rastin kur Asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të kuotave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
3. Nëse Asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në paragrafin e mësipërm të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 13

Marrja e vendimeve

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
 - a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b. emërimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - c. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d. përcaktimin e shpërblimeve të personave të përcaktuar në pikat b dhe c të këtij paragrafi;
 - dh. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

- f. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - g. pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - h. miratimin e pasqyrave financiare vjetore të shoqërisë dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
3. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

Neni 14

Përjashtim nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga Shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 15

Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga një administrator i cili caktohet në statutin e Shoqërisë dhe më pas nga Vendimet Asamblesë së Ortakëve. Administratori qëndron në detyrë për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh me të drejtë rrimërimi nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.
2. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
- a. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç. përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh. kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e. raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - ë. kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
 - f. të therrase Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- i. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- ii. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- iii. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

4. Administrator i Shoqërisë është **Gert Moçka** shtetas shqiptar, i biri i Zamirit, lindur në Vlorë më 08.11.1979, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. H91108038I, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Specimeni i nënshkrimit të Administratorit është sipas përcaktimit në shtojcën 2 bashkëlidhur statutit.

Neni 16

Përgjegjësitë e Administratorit

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj Shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.
2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm Shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.
3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të Shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim. Nëse



administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, të parashikuara, është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

5. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit, "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.
6. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 17

Marrëdhëniet e punës

1. Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj Shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 18

Konfidencialiteti dhe

Ruajtja e sekretit

1. Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga Administratori i Shoqërisë.

KREU IV

VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

Neni 19



Viti financiar

1. Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjithësisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet në 31 Dhjetor.

Neni 20

Ekspertët

1. Kontrolli mbi veprimtarinë e Shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e Shoqërisë i besohet një eksperti. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të Shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
2. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V

PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 21

Prishja dhe likuidimi

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
 - d) me vendim të gjykatës;
 - dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.
2. Në rast se Shoqëria shpërndahet për çdo lloj arsye Asambleja e Ortakëve përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidator dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për ç'rregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Rregjistrimit. Në rast se ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

Neni 22

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi- ndarja

1. Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe

SHTOJCA 1
(ORTAKET E SHOQËRISË)

1. **FATION VEIZAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Sulo, lindur ne Vlorë, më 18/09/1966, banues në Tiranë, në adresën Rruga “Brigada VIII”, Pallati Nr. 5, Apartamenti 3, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. G60918033N, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

2. **BESNIK LESKAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Astritit, lindur më 30.06.1976, banues në Tiranë, në adresën Blv “Bajram Curri”, Pallati Nr. 6 mbajtës i kartës së identitetit me Nr. 027826491, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

3. **REDJAN BASHA**, shtetas shqiptar, i biri i Nylbiut, lindur ne Lazarat më 08.03.1984, banues në Tiranë, në adresën Blv “Gjergj Fishta”, Kulla Nr. 5, Kati 13, Ap. 65, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. I40308092C, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.



SHTOJCA 2

(Specimeni i Nënshkrimit të Administratorit)

Gert Hoça

A stylized handwritten signature in black ink, consisting of a large circular loop on the right side and a long, sweeping horizontal stroke on the left side that crosses through the center of the circle.